2015

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

DEPARTAMENTI PËR PERFORMANCË DHE TRANSPARENCË TË KOMUNAVE DIVIZIONI PËR PERFORMANCË TË KOMUNAVE

RAPORTI I PERFORMANCES SË KOMUNAVE 2014

Prishtinë, Janar 2015

DEPARTAMENTI PER PERFORMANCE DHE TRANSPARENCE KOMUNALE
DIVIZIONI PER PERFORMANCE KOMUNALE

Mbikëqyrur nga:
Avni Sahiti Udhëheqës i Departamentit për Përformancë Komunale

***Hartuar nga*:**

Isuf ZENELI, Udhëheqës i Divizionit për Performancë të Komunave
Haxhi KRASNIQI, Zyrtar i Lartë për Zhvillim të Performancës së Komunave
Lazar MITIQ, Zyrtar për Performancë të Komunave
Ziadin BIQKAJ, Zyrtar për Performancë të Komunave

Copyright. 2013 – Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Republika e Kosovës, 10 000 Prishtinë
Tel. +381 (0) 38 213 077 / ëëë.rks-gov.net

Përmbajtja

SHKURTESAT 5
KAPITULLI I 6
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE 6
1. Përmbledhja ekzekutive 6
KAPITULLI II 8
VËREJTJET HYRËSE 8
1. Hyrje 8
2. Qëllimi 8
3. Përfituesit 9
4. Metodologjia e punës 9
5. Struktura e raportit 10
KAPITULLI III 11
PERFORMANCA E KOMUNAVE 11
1. Performanca e përgjithshme e ofrimit të shërbimeve 11
2. Performanca e komunave sipas fushave përkatëse 11
2.1. Pasqyrimi i të dhënave të raportuara 12
2.1.1. Shërbimet administrative 12
2.1.2. Mirëqenia sociale 13
2.1.3. Kulturë, rini dhe sport 15
2.1.4. Menaxhimi i emergjencave lokale 17
2.1.5. Planifikimi urban 18
2.1.6. Parqet dhe sheshet 19
2.1.7. Rrugët 21
2.1.8. Trotuaret 22
2.1.9. Transporti publik komunal 24
2.1.10. Parkingjet publike 25
2.1.11. Ndriçimi publik 27
2.1.12. Furnizimi me ujë 28
2.1.13. Kanalizimi dhe higjiena publike 30
2.1.14. Grumbullimi i mbeturinave 32
2.1.15. Deponimi i mbeturinave të ngurta 33
3. Efikasiteti dhe efektiviteti i performancës së komunave 35

KAPITULLI IV 37
AZHURITETI 37
4.1. Pasqyra e përgjithshme e azhuritetit të komunave 37
4.2. Efikasiteti dhe efektiviteti i azhuritetit të komunave 38
KAPITULLI V 39
NDIKIMET E PERFORMANCËS DHE AZHURITETIT 39
5.1. Ndikimet në funksionimin e sistemit të VQL 39
5.2. Ndikimet në punën e komunave 39
5.3. Ndikimet në ofrimin cilësor të shërbimeve 39
SHTOJCA 1: PASQYRA INDIVIDUALE E TË DHËNAVE PËR AZHURITETIN E KOMUNAVE 41

SHKURTESAT

MAPL	Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
SMPSHK	Sistemi i Menaxhimit të Performancës së Shërbimeve Komunale
LVL	Ligji për Vetëqeverisje Lokale
PL	Pushteti Lokal
USAID	Agency for International Development
DEMI	Iniciativa për Komunal Demokratike dhe Efektive
LOGOS	Lokal Governace and Decentralization Support
CSC	Citizens Service Center
CMS	Content Management System
KASH	Korniza Afatmesme e Shpenzimeve

KAPITULLI I

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përmbledhja ekzekutive

Matja e performancës së komunave është një proces i ndërlikuar dhe mjaftë profesional që zbatohet për ta kuptuar shkallën e përmbushjes së kërkesave të qytetarëve nga ana e pushtetit lokal (PL). Komunat dhe sistemi i vetëqeverisjes lokale ekzistojnë apo janë themeluar për t'u ofruar shërbimet e nevojshme qytetarëve. Komunat janë duke u ofruar lloje të ndryshme të shërbimeve në përputhje me pritjet dhe kërkesat e qytetarëve të saj. Ekziston një listë e pritjeve themelore të përcaktuara edhe me Ligjin e Vetëqeverisjes Lokale (LVL) dhe lista e shërbimeve specifike të bazuara në nevojat dhe kërkesat e qytetarëve të komunave përkatëse. Llojet e pritjeve kanë të bëjnë me nevojat e ndryshme të qytetarëve për shërbime, ndërsa performanca e komunave ka të bëjë me matjen e nivelit të ofrimit të këtyre shërbimeve. Pritjet e qytetarëve janë bazë për kompetencat dhe funksionet e komunave për ofrimin e shërbimeve të tyre. Në bazë të kësaj komunat ofrojnë tri grupe të mëdha të shërbimeve nga: 1) Kompetencat vetanake; 2) Kompetencat e deeguara dhe 3) Kompetencat e zgjeruara.

Aktualisht Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (SMPSHK) bën matjen e 15 fushave të ndryshme themelore nga kompetencat vetanake të komunave. SMPSHK funksionon dhe siguron matjen e performancës në secilën fushë duke u bazuar në rezultatet dhe treguesit përkatës. Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave janë: Shërbimet Administrative; Mirëqenie Sociale; Kulturë, Rini dhe Sport; Menaxhimi i Emergjencave Lokale; Planifikimi Urban; Parqet dhe sheshet; Rrugët; Trotuaret; Transporti publik komunal; Parkingjet publike; Ndriçimi Publik; Furnizimi me ujë; Kanalizimi dhe higjiena publike; Grumbullimi i mbeturinave dhe Deponimi i mbeturinave të ngurta. Në vitin 2014 janë zhvilluar edhe dy fusha të reja, të cilat janë në proces të miratimit, ndërsa në plan janë të zhvillohen edhe dy fusha të reja nga kompetencat vetanake për vitin 2015.

Matja e performancës së komunave është zhvilluar nëpërmjet vështërësive dhe mangësive të caktuara profesionale, të përvojës dhe atyre buxhetore. Duhet të themi se në këtë proces të ndërlikuar, MAPL u ndihmua shumë nga disa organizata ndërkombëtare, si: USAID, DEMI, Suiss Intercooperation, LOGOS etj., dhe në bashkëpunim të ngushtë me komunat e Republikës së Kosovës. Periudha kohore nga muaji janar deri në muajin dhjetor të vitit 2014 për komunat e Republikës së Kosovës paraqet vazhdimësinë e përpjekjeve, sukseseve dhe të arriturave në ofrimin kualitativ të shërbimeve për qytetarët, por edhe të vështirësive me të cilat ballafaqohen komunat në aktivitetet e vazhdueshme të tyre.

Pjesë përbërëse e Raportit Vjetor të Performancës së komunave për vitin 2014 do të jetë edhe Raporti i Azhuritetit dhe Efikasitetit të Organeve Komunale. Edhe në këtë pjesë të raportit do të shihen të dhënat të cilat tregojnë nivelin e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve administrative për qytetarët. Këto të dhëna janë siguruar nga platforma e përbashkët

elektronike CSC/CMS. Të dhënat për pjesën e azhuritetit dhe efikasitetit të organeve nëpër komuna, të cilat janë siguruar nga kjo platformë, për komunat do të paraqesin një sfidë e cila i obligon komunat për përdorimin e kësaj platforme të përbashkët elektronike. E gjithë kjo paraqet një përparësi të madhe për komunat dhe MAPL-në, në kuptimin e ofrimit të shërbimeve për qytetarët, evidentimin e të gjitha transaksioneve të bëra nga ana e komunave dhe njëkohësisht raportimin shumë të lehtë të këtyre të dhënave. Procesi i menaxhimit të performancës komunale përfshinë në vazhdimësi zhvillimin e kapaciteteve dhe certifikimin e zyrtarëve komunalë për përdorimin e sistemit menaxhues të performancës së shërbimeve komunale (SMPSHK). I tërë sistemi është i ndarë në dy pjesë të veçanta, por që gjithsesi janë të ndërlidhura në mes veti: (1) mbledhja e të dhënave mbi treguesit matës të performancës dhe (2) përpunimi (analiza) e këtyre të dhënave, mbi bazën e të cilit nxirren përfundimet për performancën e komunave në ofrimin e shërbimeve që aktualisht maten.

SMPSHK vazhdimisht po zhvillohet dhe po zgjerohet. Kështu, në raportin e vitit 2014 të performancës dhe azhuritetit të komunave janë përfshirë edhe të dhënat nga organet komunale të Mitrovicës së Veriut. Zyrtarët e Komunës së Mitrovicës së Veriut kanë marrë pjesë normalisht në trajnimet e mbajtura me komunat e tjera me qëllim të certifikimit të tyre për SMPSHK. Në dhjetor 2014 është organizuar një punëtori me koordinatorët komunalë për performancë për informimin e tyre për funksionimin e SMPSHK. Krahas ndërtimit të kapaciteteve zyrtare e administrative të komunave: Leposaviq, Zubin-Potok dhe Zveçan, SMPSHK do t'i përfshijë edhe këto komuna në platformën e përbashkët elektronike CSC/CMS. MAPL, përpos konsolidimit profesional dhe juridik të sistemit, tani është duke planifikuar zhvillimin e mekanizmave profesionalë dhe administrativë për rritjen e cilësisë së matjes dhe vlerësimit të performancës së komunave.

Analizat e të dhënave të bëra nga viti 2010 deri në vitin 2013, tregojnë për një rritje mesatare të performancës së komunave, me ulje dhe zbritje të caktuara për fushat e caktuara dhe në komunat e caktuara. Është me interes të theksohet se përqindja mesatare e kënaqshmërisë së qytetarëve me nivelin e ofrimit të shërbimeve komunale nga viti 2010 – 2012 është më e lartë (46%) sesa matja institucionale nga ana e MAPL, që është 41%. Nga kjo kuptojmë se për tre vitet e kaluara, mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave ka qenë 44%, apo 6% nën mesatarën e mundshme prej 50%. Komunat e Republikës së Kosovës në vitin 2014 kanë arritur një mesatare të performimit të tyre në shkallën prej 54.77%. Rritja e performancës për 10%, krahasuar me vitin 2012, tregon për trendin e rritjes së performimit të komunave prej 5% në vit.

Analizat tregojnë se komunat kanë treguar një shkallë mesatare në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit. Efikasiteti dhe efektiviteti i performancës së komunave është relativisht vështirë i konstatueshëm për faktin sepse treguesit e performancës masin vetëm sasinë e punëve të kryera, pa i krahasuar me ndonjë standard apo me atë çfarë ka qenë e planifikuar të realizohet.

KAPITULLI II

VËREJTJET HYRËSE

1. Hyrje

Matja e performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët është pjesë e ciklit të sigurimit të cilësisë në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve nga ana e komunave. Matja e performancës përfshinë dy dimensione kryesore: 1). Matja e brendshme nga ana e vetë drejtorive dhe komunës dhe 2). Matja e jashtme që bëhet nga MAPL në bazë të të dhënave të gjeneruara dhe të raportuara nga komunat përkatëse. Matja e brendshme bëhet nëpërmjet shumë instrumenteve, si nëpërmjet mbledhjes, po ashtu edhe nëpërmjet përpunimit të të dhënave nga sektorë të ndryshëm të komunës. Komuna mund ta hartojë një raport të vetin për matjen dhe vlerësimin e brendshëm të performancës, por ajo mund ta matë performancën e saj edhe nëpërmjet raportimit të jashtëm. Ndërkaq MAPL e matë performancën e përgjithshme dhe atë individuale të secilës komunë, sipas fushave përkatëse, nëpërmjet krahasimit të të dhënave me treguesit dhe me rezultatetet e fushave përkatëse. MAPL e bën përpunimin objektiv të të dhënave të raportuara nga komunat dhe nxjerrë gjetjet e përparimit apo të përkeqësimit të performancës së komunave. Për të siguruar vlefshmërinë e të dhënave, MAPL bën verifikimin e të dhënave në komunat përkatëse.

Sistemi për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (SMPSHK) është i ndërtuar prej dy kategorive të treguesve: 1). *Treguesit institucionalë - treguesit e matur nga zyrtarët komunalë dhe 2). Treguesit që reflektojnë kënaqshmërinë e qytetarëve me shërbimet komunale.* Procesi është në fillimet e zhvillimit të tij. Ende nuk janë zhvilluar kriteret (standardet) e vlerësimit të performancës. Procesi është në fazën e matjes dhe pritetet që në të ardhmen sistemi të zhvillohet në drejtim të përcaktimit të kritereve për vlerësim dhe të zgjerimit të vlerësimit të fushave për të cilat u ofrohen shërbime qytetarëve. Matja e performancës pa zhvillimin e standardeve është më e vështirë, por përmirsimi apo përkeqësimi i performancës së komunave bëhet duke i krahasuar të dhënat nga viti në vit. Ky është një sistem i hapur i matjes së performancës, që është në përputhje edhe me sistemin e përgjithshëm administrativ në Republikën e Kosovës.

2. Qëllimi

Me anën e matjes së performancës dhe të azhuritetit të komunave të Republikës së Kosovës synohet të përcaktohet shkalla ekzistuese dhe trendi i përmirësimit apo i përkeqësimit të performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve në mënyrë efektive dhe efikase për qytetarët e komunës përkatëse, apo të komunave në përgjithësi. Përparësitë e shënuara dhe dobësitë e shfaqura gjatë punës nëpërmjet ***krahasimit të shkallës aktuale të performancës dhe të azhuritetit me ato të viteve të kaluara,*** për të matë në mënyrë sa më të saktë shkallën e performancës së komunave dhe identifikimin e nevojave për zhvillim dhe përmirësim të saj.

3. Përfituesit

Njëri ndër qëllimet kryesore të raportit është mundësia e përfitimit të përgjegjësve kryesorë për performancën dhe azhuritetin e ofrimit të shërbimeve në komunë. Në këtë grup bëjnë pjesë komunat, kompanitë publike të ofrimit të shërbimeve për qytetarët dhe MAPL. Rezultatet e performancës po shfrytëzohen nga komunat për përmirësim të planifikimit, në veçanti të planifikimit të buxhetit në përputhje me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve (KASH), ndërsa MAPL për përmirësimin e zhvillimit të politikave në funksionimin e vetëqeverisjes lokale. Përveç këtyre, nga raporti mund të përfitojnë edhe institucionet e tjera qendrore dhe lokale, duke përfshirë këtu shoqërinë civile dhe në veçanti qytetarët e komunave përkatëse.

4. Metodologjia e punës

E tërë puna është bazuar në Rregulloren e Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Shërbimeve Komunale (tani e tutje Rregulloren). Në këtë proces të rëndësishëm dhe mjaftë të ndjeshëm, janë përdorë metodat më praktike për matjen e performancës dhe të azhuritetit të komunave. Metoda kryesore ka qenë bashkërendimi i drejtpërdrejtë, nëpërmjet sistemit elektronik CSC/CMS, të MAPL me të gjitha komunat përkatëse. Fillimisht është bërë informimi i kordinatorëve komunalë të performancës për mënyrën e funksionimit sistemit dhe futjen e të dhënave në sistemin për menaxhimin e performancës komunale. Në përputhje me udhëzimet e Rregullorës, komunat i kanë futë të dhënat në sistem nga 01 janar deri më 15 janar 2015. Deri më 15 janar 2015 të dhënat i kanë dërguar 35 komuna, ndërsa 2 komuna: Zubin-Potoku dhe Zveçani, i kanë dërguar të dhënat nëpërmjet zyrtarëve të UNDP. E vetmja komunë e cila nuk i ka dërguar të dhënat për performancë është Leposaviqi, ndërsa për pjesën e azhuritetit të komunave, të dhënat nuk i kanë dërguar këto komuna: Leposaviqi, Zubin-Potoku dhe Zveçani. Gjatë punës në MAPL janë përdorë edhe metodologji të tjera profesionale, si: mbledhja empirike e të dhënave, krahasimi (analiza), sistematizimi (kategorizimi), verifikimi dhe korrigjimi, nxjerrja e përfundimeve dhe raportimi.

Në përgjithësi probleme të mëdha në procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave dhe hartimit të raportit nuk ka pasur. Probleme janë hasur në funksionimin e sistemit në Komunën e Podujevës, të Obiliqit dhe të Vitisë, ndërsa kapacitetet e ulëta të sistemit në komunat e mëdha e kanë pamundësuar nxjerrjen e të dhënave për azhuritetin dhe janë përdorë metoda jostandarde të teknologjisë për nxjerrjen dhe raportimin e të dhënave. Besojmë se në të ardhmen këto probleme do të adresohen dhe do të evitohen me kohë. Gjithashtu, disa komuna për disa tregues i kanë futë të dhënat në sistem me gabime numerike dhe logjike dhe kemi qenë të detyruar që të kërkojmë nga komunat përsëri verifikimin e tyre. Edhe pse në masën më të madhe janë raportuar korrigjimet e kërkuara, prapë për disa shërbime janë hasur gabime logjike dhe numërike. Mesatarja e të dhënave të përpunuara është përdorë si standard i performancës së komunave. Rezultatet e përpunimit të të dhënave janë shndërruar në përqindje për ato shërbime që nuk është kërkuar përqindja, ndërsa në disa raste, si: mirëqenia sociale, kulturë, rini dhe sport, parqet dhe sheshet dhe e parkingjeve publike është nxjerrë mesatarja e treguesit përkatës dhe mesatarja e përgjithshme për fushën përkatës. Janë nxjerrë përqindjet mesatare të

performancës për secilin shërbim dhe përqindja e përgjithshme e performancës për të gjitha shërbimet. Kjo është bërë me qëllim që pas përfundimit të dokumentit, raporti është hedhë në diskutim të brendshëm dhe pastaj është zhvilluar versioni përfundimtar i raportit.

5. Struktura e raportit

Për ta pasqyruar më mirë përmbajtjen e raportit, lënda e trajtuar është e ndarë në gjashtë kapituj. Në kapitullin e parë flitet për ndërlidhjen ekzekutive dhe metodologjinë e përdorur në mbledhjen e të dhënave dhe hartimin e raportit. Në kapitullin e dytë janë dhënë vërejtjet hyrëse, qëllimi i raportit, struktura e raportit dhe përfituesit e raportit. Në kapitullin e tretë është përfshirë përmbajtja kryesore e raportit për matjen e performancës së komunave për 15 fushat e ofrimit të shërbimeve themelore. Në kapitullin e katërt janë përmbledhë të dhënat statistikore për azhuritetin dhe efikasitetin e administratës komunale. Në kapitullin e pestë janë përmbledhedhë të dhënat që flasin për ndikimin e performancës dhe të azhuritetit në punën e komunave në ofrimin cilësor të shërbimeve për qytetarët.

KAPITULLI III

PERFORMANCA E KOMUNAVE

1. Performanca e përgjithshme e ofrimit të shërbimeve

Matja e performancës së komunave është një proces shumë i ndërlikuar. Këtë e bën edhe më të ndërlikuar fakti se mungojnë standardet për ofrimin e shërbimeve, apo mjetet përkatëse profesionale që e bëjnë matjen e performancës më objektive. Matja bazohet vetëm në tregues të cilët nuk janë të shkallëzuar për matjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara. Nxjerrja e përfundimeve për përmirësimin, apo përkeqësimin e performancës së komunave mund të kuptohet vetëm nëpërmjet krahasimit të të dhënave nga viti në vit. Me këtë lloj të matjes nuk mund ta vlerësojmë nëse komuna e ka ofruar shërbimin e caktuar në sasinë dhe cilësinë e nevojshme, apo jo. Megjithatë, me anën e këtij sistemi dhe të këtij raporti mund ta matim dhe ta kuptojmë trendin e ofrimit të shërbimeve, që janë në përgjegjësinë e komunave.

Me organizimin administrativ dhe territorial të Republikës së Kosovës, aktualisht ekzistojnë 38 komuna, 10 prej tyre janë me shumicë serbe, 1 me shumicë turke dhe 27 me shumicë shqiptare. Në bazë të shënimve zyrtare, prej 38 komunave, kanë raportuar gjithsej 37 komuna dhe vetëm Leposaviqi nuk ka raportuar. Të dhënat janë raportuar nga komunat për 15 fusha të veçanta që hyjnë në grupin e kompetencave vetanake (shërbimet themelore).

Përpunimi i të dhënave ka treguar se komunat kanë treguar një shkallë mesatare të performancës në ofrimin e shërbimeve. Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave është 55%. Për një performancë të shkallës mesatare tregojnë edhe rezultatet e fushave përkatëse: 7 fusha kanë treguar rezultate mbi mesatarën e vendit, 7 fusha janë nën mesatarën e vendit dhe 1 fushë është e barabart me mesatarën e vendit. Ndërkaq, komunat kanë treguar performancë më të mirë në këto fusha: shërbime administrative (86%), emergjencat lokale (85%), planifikimin urban (66%) dhe transportin publik (61%). Fushat që kanë treguar performancë më të ulët janë: kulturë, rini dhe sport (33%), parqet dhe sheshet (34%), ndriçim publik (34%) dhe deponimi i mbeturinave (46%). Në raport nuk është pasqyruar shkalla e performimit sipas komunave. Qëllimi kryesor i raportit të performancës është matja e shkallës së performancës së komunave në ofrimin e shërbimeve për qytetarët dhe jo klasifikimi i komunave në këtë proces të rëndësishëm.

2. Performanca e komunave sipas fushave përkatëse

Aktualisht SMPSHK bën matjen e 15 fushave të ndryshme themelore nga kompetencat vetanake të komunave. SMPSHK funksionon dhe siguron matjen e performancës në secilën fushë duke u bazuar në rezultatet dhe treguesit përkatës. Fushat themelore për të cilat bëhet matja e performancës së komunave janë: Shërbimet Administrative; Mirëqenie Sociale; Kulturë, Rini dhe Sport; Menaxhimi i Emergjencave Lokale; Planifikimi Urban; Parqet dhe sheshet; Rrugët; Trotuaret; Transporti publik komunal; Parkingjet publike; Ndriçimi Publik; Furnizimi me ujë;

Kanalizimi dhe higjiena publike; Grumbullimi i mbeturinave dhe Deponimi i mbeturinave të ngurta.

Secila fushë e shërbimit ofrohet në kuadër të një strukture organizative apo drejtorie. Në përputhje me kompetencat që ka komuna, administrata komunale ofron 29 lloje të ndryshme të shërbimeve. Komunat nuk kanë themeluar 29 drejtori, por shërbimet me natyrë të përafërt i kanë organizuar në kuadër të një drejtorie përkatëse. Numri më i madh i drejtorive në komuna është 20 dhe më i vogli është 8 drejtori. Nuk ka ndonjë standard të veçantë se cilat shërbime organizohen në drejtoritë përkatëse. As burimet njerëzore (BNj) nuk janë të shpërndara njësoj në drejtoritë e ndryshme. Numri më i madh i BNj, 23% e tyre punon në drejtorinë e administratës, 16% e të punësuarve punojnë në drejtorinë e shërbimeve publike dhe 60% e të punësuarve tjerë janë të shpërndarë, mesatarisht nga 8.6% në 7 drejtoritë tjera. Drejtorati i prokurimit është më i vogli me vetëm 61 të punësuar ose 0.9%.



Graf. 1. Shpërndarja e kapaciteteve njerëzore sipas drejtorive të komunave për ofrimin e shërbimeve përkatëse[1]

2.1. Pasqyrimi i të dhënave të raportuara

Prej 38 komunave, 35 komuna kanë raportuar sipas kohës së planifikuar me SMPSHK, 2 komuna kanë raportuar me vonesë dhe 1 komunë nuk ka raportuar fare. Në 3 komunat me shumicë serbe ende nuk janë krijuar kushtet e nevojshme administrative për funksionimin e plotë të SMPSHK dhe në 4 tjera ende ka probleme me funksionimin e sistemit. Pasqyrimit të të dhënave i ka parapritë një fazë e përpunimit dhe e verifikimit të tyre nga ana e MAPL dhe e komunave. Nga të dhënat e raportuara është krijuar baza elektronike e të dhënave, nga e cila pastaj është bërë përpunimi i tyre sipas fushave dhe treguesve përkatës. Prej 29 fushave të shërbimeve komunale, MAPL aktualisht matë performancën e komunave vetëm për 15 fusha dhe 95 tregues përkatës. Në vazhdim po i pasqyrojmë të dhënat e përpunuara sipas fushave përkatëse.

2.1.1. Shërbimet administrative

Përfaqësojnë shtyllën kryesore të ofrimit të shërbimeve të qytetarëve. Edhe ashtu administrata përfaqëson drejtorinë më të madhe në kuadër të komunës, me 23% të burimeve njerëzore të

[1] MAPL, Dokument Analizë: Kriteret e Madhësisë së Administratës Lokale, 2014, Prishtinë

përgjithshme të angazhuara në te. Raporti pasqyron performancën e komunave për një tregues: % e lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2014. Për matjen e këtij teguesi janë mbledhur dy lloje të dhënave: Numri i gjithëmbarshëm i lëndëve dhe Numri i lëndëve të shqyrtuara brenda vitit 2014.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave në këtë fushë është 86.11% (me 6470 lëndë të pa shqyrtuara). Komunat të cilat kanë shënuar performancë më të lartë janë: Gllogofc (103%), Podujevë, Skënderaj, Shtime, Shterpcë, Viti, Hani i Elezit, Graçanicë, Ranilluk dhe Zveçan (99%), ndërsa komuna me performancë më të ulët është Novobërda (8%), Kamenica (11%) dhe Deçani (17%). Grupi më i madh i komunave ka arritë performancë mbi 90% apo mbi mesatarën e vendit prej 86.11%. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Të dhënat për shërbimet administrative janë marrë nga sistemi për matjen e azhuritetit.



Graf. 2. *Performanca e komunave për shërbimet administrative*

2.1.2. Mirëqenia sociale

Përfaqësojnë fushën e cila ka të bëjë me ofrimin e shërbimeve të qytetarëve të cilët kanë nevojë për ndihmën e institucioneve publike. Numri i familjeve të cilët përfitojnë nga skema sociale janë 27380, prej tyre 500 familje janë përfituese të reja të skemës sociale, vetëm në tre muajt e fundit[2]. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet pesë treguesve: *1) Numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar që janë të punësuar në institucione komunale; 2) Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë; 3) Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive; 4) Numri i rasteve nën përkujdesje sociale dhe 5) Numri i ankesave për shërbimet sociale*.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Numri i përgjithshëm i të punësuarve me aftësi të kufizuar në komuna është 58 persona. Komunat që kanë më së shumti të punësuar janë: Mitrovica e Veriut (9 persona), Skenderaj (8 persona) dhe Mitrovica(5 persona). Komunat që nuk kanë të punësuar asnjë person me aftësi të

[2] Muhamet Gjoci, Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale, shkurt 2015, Prishtinë

kufizuar janë: Gllogofci, Gjilani, Dragashi, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Shtimja, Peja, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Graçanica, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani.

Gjatë vitit 2014 komunat kanë pranuar gjithsej 2374 kërkesa për banim/strehim. Komunat që kanë pasë numër më të madh të kërkesave janë: Gjilani dhe Ferizaji (396 - 360 kërkesa), ndërsa komunat që kanë numër më të vogël të kërkesave janë: Novobërda dhe Vitia (6 – 8 kërkesa) dhe komunat që nuk kanë pasë asnjë kërkesë janë: Obiliqi, Shtërpca, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani (10 komuna). Në bazë të kërkesave dhe kapaciteteve të komunave janë strehuar gjithsej 997 familje. Komunat që kanë strehuar më së shumti familje, janë: Graçanica (107 familje), Deçani (86 familje), Podujeva (74 familje) dhe Klina (71 familje), ndërsa komunat që nuk kanë strehuar asnjë qytetar janë: Dragashi, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Skenderaj, Shtimja, Suhareka, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani (13 komuna). Mesatarja e përgjithshme e numrit të familjeve të strehuara është 40 familje. Numri më i madh i komunave ka strehuar më pak familje se mesatarja e vendit.

Në bazë të skemës sociale të komunave, numri i përgjithshëm i rasteve nën përkujdesje sociale është 33685. Numri më i madh i përfituesve për përkujdesje sociale janë në komunat: Prishtinë (4100), Mitrovicë (2135) dhe Gjilan - 2082 qytetarë), ndërsa numri më i vogël i qytetarëve që kanë pas përkujdesje sociale janë në komunat: Mamusha, Parteshi, Dragashi (32 – 35 qytetarë). Mesatarja e përgjithshme e rasteve që janë në përkujdesje sociale është 823 qytetarë. Shumica e komunave është nën mesatarën e vendit.

Komunat me numrin më të madh të ankesave për shërbime sociale janë: Skenderaji (277), Mitrovica (211), Ferizaji (180) dhe Prizreni (176), ndërsa komunat që nuk kanë pasur ankesa janë: Dragashi, Mamusha, Parteshë, Kaçaniku dhe Obiliqi, Zubin-Potoku, Mamusha, Ranillugu, Parteshi dhe Zveçani (11 komuna). Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.1.

Tab.1. *Performanca e komunave sipas treguesve social.*

Komunat	Numri i rasteve të personave me aftësi të kufizuar që janë të punësuar në institucione komunale	Numri i kërkesave për banim/strehim të rasteve sociale dhe njerëzve në nevojë	Numri i familjeve të vendosura në strehimore kolektive	Numri i rasteve nën përkujdesj e sociale	Numri i ankesave për shërbimet sociale
Gjithsej	58	2374	806	30453	**493.63**
Deçan	10	21	86	628	21.39
Gjakovë	4	193	49	1135	28
Gllogoc	0	91	1	1522	9,80
Gjilan	0	396	54	2082	20.17
Dragash	0	35	0	32	20.17
Istog	0	30	18	673	14.95
Kaçanik	1	25	9	85	10.08
Klinë	2	34	71	970	9
Fushë-Kosovë	8	80	58	748	11.84
Kamenicë	2	60	30	609	7.5
Mitrovicë	5	79	23	2135	11
Leposaviq	0	0	0	0	0

Lipjan	1	85	25	1582	14
Novobërdë	0	6	0	403	13.5
Obiliq	0	0	0	750	15
Rahovec	0	126	0	1049	0.1
Pejë	0	85	3	247	6.94
Podujevë	1	82	74	817	15
Prishtinë	1	105	44	4100	8,00
Prizren	1	147	23	1398	137.24
Skenderaj	8	135	0	1163	12,00
Shtime	0	13	0	832	0.18
Shtërpcë	1	0	25	256	10
Suharekë	3	27	0	650	12.98
Ferizaj	0	360	13	930	21.41
Viti	1	8	25	1280	17.01
Vushtrri	1	146	65	1520	13.59
Zubin-Potok	3	39	28	442	0.37
Mitrovica e Veriut	9	0	19	1252	8.21
Malishevë	0	11	3	2	15
Hani i Elezit	0	0	2	275	12
Mamushë	0	0	0	32	9.12
Junik	0	0	0	125	7.1
Kllokot	0	0	0	101	0
Graçanicë	0	68	107	310	20.71
Ranillug	0	0	0	241	10
Partesh	0	0	0	35	1.25
Zveçan	0	0	0	42	0

2.1.3. Kulturë, rini dhe sport

Është fushë shumë e rëndësishme që komuna u ofron qytetarëve të saj, duke pasur parasysh se pjesa zotëruese e popullsisë së Kosovës janë të rinj dhe kanë nevojë për ofrimin e këtyre shërbimeve. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet katër treguesve: *1) Gjithsej numri i aktiviteteve komunale në tri sektoret – kulturë, rini dhe sport; 2) Gjithsej objekte sportive në komunë: 3) Gjithsej objekte për aktivitete rinore në komunë; 4) Gjithsej objekte për aktivitete kulturore në komunë .*

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Numri i përgjithshëm i aktiviteteve për kulturë, rini dhe sport në komuna është 4223. Komunat që kanë më së shumti aktivitete janë: Ferizaj (642 aktivitete) Vitia (430 aktivitete) dhe Fushë-Kosova (428 aktivitete), ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të aktiviteteve në këtë fushë janë: Zveçani (0 aktivitete), Zubin-Potoku, Novobërda, Obiliqi, Hani i Elezit dhe Parteshi (6 – 13). Mesatarja e përgjithshme e numrit të aktiviteteve për rini, sport dhe kulturë në komuna është 114. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit.

Komunat kanë ndërtuar gjithsej 426 objekte sportive. Më së shumti objekte sportive ka ndërtuar Komuna e Prishtinës dhe e Gjakovës me 46 objekte, pastaj Fushë-Kosova (25 objekte) dhe Shtimja e Graçanica nga 23 objekte, ndërsa komunat që kanë ndërtuar më së paku objekte sportive janë: Novobërda dhe Kllokoti nga 1 objekt, Suhareka dhe Kamenica 3 dhe Deçani, Gllogofci, Obiliqi dhe Mamusha nga 4 objekte. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve

sportive është 11.53. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit. Numri i përgjithshëm i objekteve për aktivitete rinore në komuna është 279.

Komunat që kanë më së shumti objekte për aktivitete rinore janë: Fushë-Kosova (25 objekte) dhe Prishtina (23 objekte), ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të objekteve për aktivitete rinore janë: Skenderaj, Zubin-Potoku, Deçani, Hani i Elezit dhe Mamusha. Obiliqi dhe Zveçani nuk kanë objekte për aktivitete rinore. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve për aktivitete rinore në komuna është 7.54 Shumica e komunave kanë më pak objekte për aktivitete rinore se mesatarja e vendit.

Numri i përgjithshëm i objekteve për aktivitete kulturore në komuna është 294. Komunat që kanë më së shumti objekte për aktivitete kulturore janë: Fushë-Kosova (25 objekte) dhe Prishtina e Podujeva nga 23 objekte, ndërsa komunat që kanë numrin më të vogël të objekteve për aktivitete kulturore janë: Skenderaj (1 objekt), Deçani, Hani i Elezit dhe Mamusha nga 2 objekte dhe Shtimja e Kllokoti nga 3 objekte. Obiliqi dhe Novobërda nuk kanë objekte për aktivitete kulturore. Mesatarja e përgjithshme e numrit të objekteve për aktivitete kulturore në komuna është 7.95. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.2.

Tab.2. *Performanca e komunave sipas treguesve për kulturë, rini dhe sport.*

Komunat	Gjithsej numri i aktiviteteve komunale në të tri sektorët: a. rini b. sport c. kulturë	Gjithsej numri i objekteve sportive në zonat komunale: a. rurale b. urbane	Gjithsej numri i objekteve për aktivitete rinore në zonat komunale: a. rurale b. urbane	Gjithsej numri i objekteve për aktivitete kulturore në zonat komunale: a. rurale b. urbane
Gjithsejt	**4223**	**426**	**279**	**294**
Deçan	118	4	2	2
Gjakovë	401	46	14	14
Gllogoc	30	4	7	7
Gjilan	48	6	13	13
Dragash	47	5	6	6
Istog	123	7	10	10
Kaçanik	32	16	6	6
Klinë	78	7	9	9
Fushë-Kosovë	428	25	25	25
Kamenicë	84	3	4	4
Mitrovicë	271	10	10	10
Leposaviq	0	0	0	0
Lipjan	55	15	7	7
Novobërdë	7	1	4	0
Obiliq	9	4	0	0
Rahovec	38	8	4	6
Pejë	117	21	14	14
Podujevë	46	20	14	23
Prishtinë	268	46	23	23
Prizren	217	14	15	15
Skenderaj	29	5	1	1
Shtime	43	23	3	3
Shtërpcë	17	15	8	8
Suharekë	18	3	5	5
Ferizaj	642	7	14	14
Viti	430	8	5	5
Vushtrri	146	8	13	13

Zubin-Potok	6	5	1	2
Mitrovica e Veriut	41	1	5	5
Malishevë	31	21	6	2
Hani i Elezit	10	6	2	2
Mamushë	23	4	2	2
Junik	71	5	9	9
Kllokot	70	1	3	3
Graçanicë	104	23	8	8
Ranillug	112	15	3	11
Partesh	13	11	4	4
Zveçan	0	3	0	3

2.1.4. Menaxhimi i emergjencave lokale

Përparësi në ofrimin e shërbimeve nga ana e institucioneve publike është ofrimi i ndihmës për të mbrojtur jetën dhe pasurinë e qytetarëve në raste emergjente. Institucionet publike kanë themeluar struktura dhe mekanizma të veçantë për reagime të shpejta. Raporti pasqyron performancën e komunave për pesë tregues: *1) Numri rasteve emergjente - fatkeqësitë (zjarre, vërshime, tërmete); 2) Vlera e pasurisë së humbur gjatë rasteve emergjente në euro në vit; 3) Numri i rasteve emergjente, për të cilat ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes; 4) Koha totale vjetore për arritjen në vend të ngjarjes për të gjitha rastet emergjente në minuta; 5) Koha mesatare e nevojshme për të arritur në vendin e ngjarjes në minuta*.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i rasteve emergjente në komuna është 8362. Komunat që kanë pasur më së shumti raste emergjente janë: Prishtina (1404 raste), Ferizaji (960 raste) dhe Mitrovica (573 raste), ndërsa komunat që kanë pasur numrin më të vogël të rasteve emergjente janë: Kllokoti (1 rast), Shterpca (4 raste), Ranillugu (8) dhe Hani i Elezit e Parteshi nga 16 raste. Mesatarja e përgjithshme e numrit të rasteve emergjente në komuna është 232.28. Shumica e komunave kanë pasur numër më të vogël të rasteve emergjente se mesatarja e vendit.

Gjatë vitit 2014 komunat nga fatkeqësitë kanë humbur pasuri në vlerë prej 3,454,014.80 euro. Më së shumti humbje ka pasur Komuna e Pejës (522,800,00 euro), e Vushtrrisë (401,770,00 euro) dhe e Istogut (384,000,00 euro), ndërsa komunat që kanë qenë më së paku të dëmtuara janë: Hani i Elezit (500 euro) dhe Parteshi (6225 euro). Mesatarja e përgjithshme e dëmeve të shkaktuara është 95944,86 euro. Numri i përgjithshëm i reagimeve të ekipeve emergjente në komuna ka qenë 7136 raste. Më së shumti raste të reagimit ka pasur Komuna e Prishtinës (1404 raste) ndërsa komuna që ka pasë më së paku raste të reagimit të ekipeve emergjente është Kllokoti (1 rast).

Mesatarja e përgjithshme e reagimeve të ekipeve emergjente në komuna është 198.22 raste. Mesatarja e përgjithshme e kohës së nevojshme vjetore për reagim të shpejtë ka qenë 122616.1 minuta. Shumica e komunave kanë reaguar më shpejtë se mesatarja e vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.3.

Tab.3. *Performanca e komunave në menaxhimin e emergjencave lokale*

Komunat	Numri rasteve emergjente - fatkeqësitë (zjarre, vërshime, tërmete)	Vlera e pasurisë së humbur gjatë rasteve emergjente në Euro në vit	Numri i rasteve emergjente, për të cilat ekipet është dashur të dalin menjëherë në vend të ngjarjes	Koha totale vjetore për arritjen në vend të ngjarjes për të gjitha rastet emergjente në minuta	Koha mesatare e nevojshme për të arritur në vendin e ngjarjes në minuta
Gjithsej	8362	3454014.8	7136	122616.1	584.68

2.1.5. anifikimi urban

Komunat janë të ballafaquara me probleme të theksuara sa i përket planifikimit dhe rregullimit urban. Përmirësimi i performancës së komunave në këtë dimension është nevojë e rëndësishme e përmirësimit të jetës së qytetarëve. Shumica e komunave kanë miratuar planet e rregullimit urban, por kanë problem në zbatimin e tyre. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet tre treguesve: *1)* Përqindja e sipërfaqes së tokës/zonës urbane për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në ha; 2) % e aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit; 3) % e kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshëm e rregullimit të sipërfaqës së zonës urbane në hektar është 49.98. Shumica e komunave kanë rregulluar sipërfaqe të zonës urbane nën mesatarën e vendit. Komuna që ka përqindje më të lartë të rregulluar të zonës urbane në hektar është: Klina dhe Shtime (100 %), Prizreni 91% dhe Peja 89.5%. Komunat që kanë përqindje më të ulët të rregulluar të zonës urbane në hektar janë: Kamenica, Novobërda, Obiliqi, Rahoveci, Shtërpca, Mitrovica e Veriut dhe Kllokoti (0 %).

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së ekzekutimit të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim është 49.98%. Shumica e komunave kanë treguar performancë nën mesatarën e vendit. Komunat të cilat kanë ekzekutuar përqindje më të lartë të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim janë: Deçani, Fushë-Kosova, Obiliqi, Rahoveci, Shterpca, Juniku, Ranillugu dhe Graçanica (100%), ndërsa komunat të cilat kanë ekzekutuar përqindje më të ulët të aktvendimeve të inspekcionit për ndërtim janë: Gllogofci, Gjilani, Kamenica, Novobërda, Suhareka, Mitrovica e Veriut, Malisheva, Hani i Elezit, Mamusha, Kllokoti dhe Parteshi (0%).

Përqindja e përgjithshme mesatare e kërkesave të shqyrtuara për leje të ndërtimit është 58.79. Më së shumti kërkesa ka shqyrtuar komuna e Deçanit, Gllogofcit, Dragashit, Fushë-Kosovës, Novobërdës, Pejës, Prizrenit, Shtimës, Junikut, Kllokotit dhe Graçanicës (100%), ndërsa më së paku kërkesa kanë shqyrtuar komunat e Suharekës, Mitrovicës e Veriut, Malishevës dhe Mamushës (0%). Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.4.

Tab. 4. *Performanca e komunave për planifikimin urban.*

Komunat	Përqindja e sipërfaqes së tokës/zonës urbane për të cilën ekzistojnë planet rregulluese në ha	% e aktvendimeve të ekzekutuara nga inspekcioni i ndërtimit	% e kërkesave të shqyrtuara për leje ndërtimi
Mesatarja	49.98	58.79	90.42

Deçan	99	100	100
Gjakovë	55.5	50	87.72
Gllogoc	25.1	0	100
Gjilan	73.28	0	86.9
Dragash	60	85.71	100
Istog	53.33	10	94.44
Kaçanik	21.22	35.14	94.38
Klinë	100	50	83.33
Fushë-Kosovë	40.12	100	100
Kamenicë	27.89	0	77.22
Mitrovicë	34.89	58.14	76.6
Leposaviq	0	0	0
Lipjan	23.64	43.64	93.44
Novobërdë	0	0	100
Obiliq	0	100	85.71
Rahovec	0	100	96.67
Pejë	89.55	46.56	100
Podujevë	26.21	94.12	98.53
Prishtinë	34.8	27.36	91.63
Prizren	91.67	18.28	100
Skenderaj	51.06	33.33	95.83
Shtime	100	4.76	100
Shtërpcë	0	100	82.98
Suharekë	34.95	0	100
Ferizaj	42	82.67	97.65
Viti	49.75	44.44	70.59
Vushtrri	13.99	61.64	94.55
Zubin-Potok	73.66	41.67	87.5
Mitrovica e Veriut	0	0	0
Malishevë	33.33	0	88.89
Hani i Elezit	28.4	0	100
Mamushë	76.6	0	0
Junik	15.2	100	100
Kllokot	0	0	100
Graçanicë	72.09	100	100
Ranillug	0	100	100
Partesh	0	0	80
Zveçan	52.29	0	0

2.1.6. Parqet dhe sheshet

Mjediset e banimit kolektiv në zonat urbane duhet të jenë me hapësirë të nevojshme dhe të qasshme edhe për ujë të pijshëm. Përmirësimi i hapësirave të banimit urban është preokupim edhe i komunave. Përmirësimi i performancës së komunave në këtë dimension është nevojë e rëndësishme e përmirësimit të jetës së qytetarëve. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m^2); 2) % e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e sipërfaqës së parqeve/shesheve për kokë të banorit është 1.16 m^2.. Shumica e komunave kanë më pak m^2

parqe/sheshe për kokë të banorit se sa mesatarja e vendit. Komunat të cilat kanë numrin më të madh të sipërfaqeve të parqeve/shesheve për kokë të banorit janë: Prishtina (5.31 m^2) dhe Graçanica (5.02 m^2), ndërsa komunat të cilat kanë numrin më të vogël të sipërfaqeve të parqeve/shesheve për kokë të banorit janë: Deçani (0.02 m^2), Kllokoti (0.04 m^2). Novobërda nuk ka fare parqe dhe sheshe. Shumica e komunave (21) kanë më pak se 1 m^2 për kokë banori parqe/sheshe se sa mesatarja e vendit 1.16 m^2. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së sipërfaqës së parqeve/shesheve me qasje të ujit të pishëm është 58.85%. Komunat me përqindje më të madhe të qasjes së ujit të pishëm në parqe/sheshe janë: Gllogofci, Kaçaniku, Fushë-Kosova, Lipjani, Obiliqi, Shterpca, Hani i Elezit, Mamusha, Juniku (100%), ndërsa komunat me përqindje më të ulët të qasjes së ujit të pishëm në parqe/sheshe janë: Kamenica, Novobërda, Mitrovica e Veriut dhe Kllokoti (0%).

Tab. 5. *Performanca e komunave për parqet dhe sheshet*

Komunat	Sipërfaqja e parkut/sheshit për kokë banori, në metër katror (m^2)	% e parqeve-shesheve komunale me qasje në ujë të pijshëm
Mesatarja	**1.16**	**58.85**
Deçan	0.02	80.00
Gjakovë	0.00	60.00
Gllogoc	0.90	100.00
Gjilan	0.72	19.35
Dragash	0.05	60.00
Istog	0.76	60.00
Kaçanik	0.44	100.00
Klinë	1.19	50.00
Fushë-Kosovë	3.88	100.00
Kamenicë	0.82	0.00
Mitrovicë	1.1	90.91
Leposaviq	0.00	0.00
Lipjan	0.46	100.00
Novobërdë	0.00	0.00
Obiliq	0.49	100.00
Rahovec	0.28	18.42
Pejë	3.30	53.57
Podujevë	1.72	37.50
Prishtinë	5.31	81.82
Prizren	0.12	97.87
Skenderaj	0.19	33.33
Shtime	0.72	77.78
Shtërpcë	0.32	100.00
Suharekë	1.18	42.86
Ferizaj	0.22	72.97
Viti	1.07	22.22
Vushtrri	0.86	45.45
Zubin-Potok	0.59	66.67
Mitrovica e Veriut	1.34	0.00
Malishevë	1.32	66.67

Hani i Elezit	0.25	100.00
Mamushë	2.00	100.00
Junik	1.02	100.00
Kllokot	0.04	0.00
Graçanicë	5.02	78.79
Ranillug	0.22	50.00
Partesh	4.2	20.00
Zveçan	0.09	50.00

2.1.7. Rrugët

Përfaqësojnë njërën ndër shtyllat kryesore të ofrimit të shërbimeve për qytetarët. Rrugët janë arteriet kryesore të qytetarëve për veprimtari të ndryshme shoqërore dhe ekonomike në komunën përkatëse. Ofrimi i këtij shërbimi është i ndërlidhur edhe me nivelin qendror, pasi që rrugët lokale janë të lidhura dhe të ndërlidhura edhe me rrugët rajonale duke krijuar sistemin rrugor për veprimtari të ndryshme të qytetarëve. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet tre tregues: 1) % e km të rrugëve, të përfshira në planin komunal për pastrim / fshirje / larje; 2) % e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara dhe 3) % e km rrugë, të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së km rrugë të planifikuara për pastrim është 33.85%. Komunat të cilat e kanë përqindjen më të lartë të km rrugë të planifikuara për pastrim janë: Kllokoti, Graçanica, Parteshi (100%) dhe Hani i Elezit (81.97%), ndërsa komunat me përqindje më të ulët të km rrugë të planifikuara për pastrim janë: Novobërda 1.9% dhe Lipjani 1.3%. Shtërpca nuk e ka të planifikuar asnjë km rrugë për pastrim.

Mesatarja e përqindjes së rrugëve në km të asfaltuara në komuna është 59.91%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të rrugëve të asfaltuara në km janë: Shtërpca 100%, Graçanica 96.14%, Parteshi 84.27% dhe Hani i Elezit (81.97% km), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të rrugëve të asfaltuara në km janë: Mitrovica e Veriut(0.0% km) dhe Suhareka (3.60% km). Numri më i madh i komunave ka treguar performancë në asfaltimin e rrugëve mbi mesatarën e vendit.

Gjithashtu komunat bëjnë mirëmbajtjen e rrugëve, në veçanti gjatë dimrit. Mesatarja e përqindjes së km rrugë të përfshira në mirëmbajtjen dimërore është 74.20%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të rrugëve të planifikuara për mirëmbajtje gjatë dimirit në km janë: Podujeva, Skenderaji, Ferizaji, Mitrovica e Veriut, Kllokoti, Ranillugu dhe Parteshi (100% km), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të rrugëve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Lipjani (25%) dhe Zveçani (23%). Numri më i madh i komunave ka treguar performancë mbi mesatarën e vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.6.

Tab.6. *Performanca e komunave sipas treguesve për rrugët.*

Komunat	% e km të rrugëve, të përfshira në planin komunal për pastrim / fshirje / larje	% e rrugëve lokale në komunë, që janë të asfaltuara	% e km rrugë, të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen dimërore të rrugëve
Mesatarja	**33.85**	**59.91**	**74.20**
Deçan	9.39	66.20	70.42
Gjakovë	28.42	73.42	28.77
Gllogoc	26.67	81.73	100.00
Gjilan	4.50	67.43	98.74
Dragash	4.47	43.16	94.74
Istog	11.49	73.56	80.46
Kaçanik	6.01	36.13	85.13
Klinë	25.00	85.82	83.96
Fushë-Kosovë	57.89	78.95	52.63
Kamenicë	1.31	78.60	96.07
Mitrovicë	57.55	82.1	97.12
Leposaviq	0.00	0.00	0.00
Lipjan	2.25	27.62	25.56
Novobërdë	1.90	37.19	77,12
Obiliq	4.56	5.72	40.00
Rahovec	7.54	50.29	79.63
Pejë	46.80	84.01	84.01
Podujevë	10.81	81.35	100.00
Prishtinë	70.34	88.40	85.55
Prizren	14.44	75.11	57.50
Skenderaj	10.33	82,35	100.00
Shtime	6.90	39.61	46.51
Shtërpcë	0.00	100.00	56.35
Suharekë	19.64	3.60	52.25
Ferizaj	29.90	80.40	100.00
Viti	33.23	81.79	81.79
Vushtrri	14.99	94.28	74.39
Zubin-Potok	77.17	19.87	46.80
Mitrovica e Veriut	72.28	0.00	100.00
Malishevë	3.14	85.03	85.03
Hani i Elezit	81.97	81.97	81.97
Mamushë	65.38	11.50	61.54
Junik	56.64	56.64	75.78
Kllokot	100.00	62.9	100.00
Graçanicë	100.00	96.14	96.14
Ranillug	100.00	61.43	100.00
Partesh	100.00	84.27	100.00
Zveçan	23.57	40.40	23.57

2.1.8. Trotuaret

Me shtimin e veturave në komunikacion dhe me nevojën e zgjerimit të rrugëve në zonat urbane, hapësira e këmbësorëve gjithnjë e më shumë po zvogëlohet. Hapësira për ecje ndikon drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së njeriut në vendbanimin e tij. Komuna është e obliguar që t'u sigurojë hapësirë të nevojshme kombësorëve për veprimtarinë e tyre në vendbanimin e tyre, por edhe hapësira për ecje të lirë dhe vrapim. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet dy treguesve: 1) % e km të trotuareve të rregulluara dhe 2) % e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së km të trotuareve të rregulluara është 29.34%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të trotuareve të rregulluara në km janë: Gllogovci (96.33%), Mitrovica 72% dhe Deçani (70% km), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të trotuareve të rregulluara në km janë: Mitrovica e Veriut (0.0%) dhe Zubin Potoku (1.14%). Numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit.

Mesatarja e përqindjes së km trotuar të përfshira në mirëmbajtje është 67.83%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të trotuareve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Gllogofci, Kaçaniku, Novobërda, Peja, Skenderaj, Shtimja, Shterpca, Vushtrria, Hani i Elezit, Juniku, Kllokoti, Parteshi, Graçanica, Ranillugu dhe Zveçani (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të trotuareve të planifikuara për mirëmbajtje në km janë: Mitrovica e Veriut(0%), Ferizaji (0%) dhe Kamenica (9%). Shumica e komunave ka treguar performancë mbi nivelin e mesatares së vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.7.

***Tab. 7**. Performanca e komunave sipas treguesve për trotuaret.*

Komunat	% e km të trotuareve të rregulluara	% e km të trotuareve të përfshira në planin komunal për mirëmbajtjen (pastrim-fshirje) verore/dimërore
Mesatarja	**29.34**	**67.83**
Deçan	70	50
Gjakovë	19.31	18.81
Gllogoc	96.33	100
Gjilan	15.72	43.41
Dragash	57.14	56.25
Istog	21.84	39.47
Kaçanik	18	100
Klinë	26.52	42.62
Fushë -Kosovë	65	87.82
Kamenicë	18.9	9
Mitrovicë	72	87
Leposaviq	0	0
Lipjan	14.46	86.33
Novobërdë	10	100
Obiliq	69.93	66.67
Rahovec	41.67	36
Pejë	18.54	100
Podujevë	13.62	97.56
Prishtinë	21.08	85.71
Prizren	47.5	23.51
Skenderaj	16.11	100
Shtime	23.58	100
Shtërpcë	5.95	100
Suharekë	17.7	23
Ferizaj	24.25	0
Viti	19.54	22.35
Vushtrri	9.31	100
Zubin-Potok	1.14	48.4
Mitrovica e Veriut	0	0
Malishevë	5.43	68
Hani i Elezit	22.5	100
Mamushë	53.85	85.71
Junik	42.76	100

Kllokot	32.94	100
Graçanicë	37.49	100
Ranillug	11.64	100
Partesh	10.39	100
Zveçan	4.17	100

2.1.9. Transporti publik komunal

Lëvizja e popullatës nga fshati në qytet e ka rritur nevojën e shtimit të kapaciteteve dhe cilësinë e ofrimit të shërbimit për transport publik të qytetarëve në vendbanimet urbane, por edhe qytet - fshat. Transporti publik gjithnjë e më shumë po bëhet problem dhe sfidë e menaxhimit të kësaj fushe. Shtimi i madh i automjeteve në komunikacion e ka vështirësur transportin publik të qytetarëve, duke krijuar kështu një fyt të ngushtë në ofrimin e këtyre shërbimeve. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet dy treguesëve: 1) % e fshatrave të përfshirë në transportin publik komunal; 2) % e vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e përqindjes së përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal është 70.79%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Fushë-Kosova, Obiliqi, Peja, Mamusha dhe Juniku (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të përfshirjes së fshatrave në transportin publik komunal janë: Mitrovicë e Veriut, Kllokot, Graçanicë dhe Partesh (0.0%). Për këtë tregues, numri më i madh i komunave ka treguar performancë mbi mesatarën e vendit.

Mesatarja e përqindjes së vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim është 51.89%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Fushë-Kosova, Lipjani, Mitrovica e Veriut, Hani i Elezit, Mamusha, Graçanica (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindjen më të ulët të vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim janë: Zubin-Potoku dhe Parteshi (0.0%). Numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit për këtë tregues. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.8.

***Tab.8**. Performanca e komunave sipas treguesve për transportin publik lokal.*

Parkingjet publike	% e fshatrave të përfshirë në transportin publik komunal	% e vendndalimeve të autobusëve të pajisur me shenjëzim
Mesatarja	**70.79**	**51.89**
Deçani	9189	15.79
Gjakovë	82.42	30.00
Gllogoc	100.00	16.59
Gjilan	80.95	38.24
Dragash	66.67	13.33
Istog	94.00	83.33
Kaçanik	87.10	63.33
Klinë	94.44	66.67

Fushë-Kosovë	100.00	100.00
Kamenicë	82.76	16.96
Mitrovicë	91.30	89.17
Leposaviq	0.00	0.00
Lipjan	90.32	100.00
Novobërdë	62.50	89.74
Obiliq	100.00	29.17
Rahovec	88.24	53.57
Pejë	100.00	71.88
Podujevë	94.87	31.79
Prishtinë	95.45	96.71
Prizren	91.89	70.22
Skenderaj	96.30	65.63
Shtime	91.30	83.33
Shtërpcë	58.82	61.54
Suharekë	80.95	7.06
Ferizaj	95.56	22.09
Viti	61.54	32.00
Vushtrri	88.06	56.10
Zubin-Potok	48.44	0.00
Mitrovica e Veriut	0.00	100.00
Malishevë	95.45	14.29
Hani i Elezit	27.27	100.00
Mamushë	100.00	100.00
Junik	100.00	62.50
Kllokot	0.00	37.50
Graçanicë	0.00	100.00
Ranillug	23.08	33.33
Partesh	0.00	0.00
Zveçan	28.57	20.00

2.1.10. Parkingjet publike

Krahas shtimit të automjeteve të qytetarëve, rritet edhe kërkesa dhe nevoja për ofrim të shërbimeve për parkimin e tyre. Hapësirat e pamjaftueshme dhe shtimi i shpejtë i numrit të veturave të qytetarëve në zonat urbane e kanë sjellë komunën para vështirësive të theksuara në ofrimin e këtyre shërbimeve. Komunat kanë ndërmarrë masa të caktuara, por ende të pamjaftueshme në ofrimin e mundësive për parkim të veturave në parkingjet publike. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet pesë treguesve: 1) Numri total i parkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 2) Numri total i parkingjeve publike të shenjëzuara (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 3) Numri total i vendparkimeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve); 4) % e parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal; 5) % e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se numri i përgjithshëm i parkingjeve publike në komuna është 2897. Mesatarja e numrit të parkingjeve publike në komuna është 76.24. Komunat të cilat kanë numër më të madh të parkingjeve publike janë: Mitrovica (1530 parkingje), Prizreni (630) dhe Prishtina (227), ndërsa komunat të cilat kanë numër më të vogël të parkingjeve publike janë: Parteshi, Kllokoti, Mitrovica e Veriut (0 parkingje), Deçani (2), Juniku dhe mamusha (3) dhe Hani i Elezit, Malisheva, Rahoveci, Klina, Shterpca (4).

Numri total i vendparkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rruge) është 25496, me një mesatare prej 670.95. Numri i përgjithshëm i parkingjeve publike të shenjëzuara në komuna është 2018. Mesatarja e numrit të parkingjeve publike të shenjëzuara në komuna është 53.11. Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal është 64.44%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të madhe të parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal në komuna janë: Gllgofci, Istogu, Fushë-Kosova, Peja, Podujeva, Prizreni, Shtimja, Vitia, Vushtrria, Malisheva, Mamusha, Juniku dhe Zveçani (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të vogël të parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal janë: Mitrovica e Veriut, Parteshi, Kllokoti, Ranillugu (0%), Zubin Potoku (5.56%). Mesatarja e numrit total të vendparkingjeve publike në komuna është 55.34.

Përqindja e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për persona me aftësi të kufizuar është 27.57%. Shumica e komunave ka treguar performancë nën nivelin e mesatares së vendit (55.34). Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.9.

Tab. 9. Performanca e komunave sipas treguesve për parkingjet publike.

Komunat	Numri total i parkingjeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	Numri total i parkingjeve publike të shenjëzuara (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	Numri total i vendparkimeve publike (në rrugë dhe jashtë rrugëve)	% e parkingjeve publike me shenjëzim horizontal dhe vertikal	% e parkingjeve publike me vendparkime të rezervuara për personat me aftësi të kufizuar
Mesatarja	**76.24**	**53.11**	**670.95**	**64.44**	**27.57**
Deçan	2	2	2	50.00	50,00
Gjakovë	11	4	557	36,36	27,27
Gllogoc	10	8	609	100,00	1,31
Gjilan	16	4	1091	56,25	62,50
Dragash	17	4	17	23,53	13.33
Istog	16	16	340	100,00	12,50
Kaçanik	7	7	4	85,71	71,43
Klinë	4	3	94	75,00	50,00
Fushë-Kosovë	28	28	1350	100,00	64,29
Kamenicë	6	2	60	33,33	50,00
Mitrovicë	1530	1030	1550	67.32	6.21
Leposaviq	0	0	0	0	0
Lipjan	15	15	260	100,00	13,33
Novobërdë	6	6	201	100,00	33,33
Obiliq	8	5	180	62,50	18,00
Rahovec	4	4	20	100,00	100,00
Pejë	8	8	220	100,00	112,50
Podujevë	29	15	2650	100,00	8,00
Prishtinë	227	100	10870	44,05	25,99
Prizren	630	630	370	100,00	7,62
Skenderaj	6	2	350	33,33	16,67
Shtime	9	9	260	100,00	11,11
Shtërpcë	4	1	4	25,00	25,00
Suharekë	42	10	1550	59,52	35,71
Ferizaj	109	29	410	51,38	8,26
Viti	7	7	238	100,00	57,14
Vushtrri	31	31	477	100,00	70,97
Zubin-Potok	18	2	190	5.56	1
Mitrovica e Veriut	0	0	0	/	/
Malishevë	4	4	0	100.00	0.00

Hani i Elezit	4	1	2	50,00	0,00
Mamushë	3	3	9	100,00	0,00
Junik	3	3	16	100,00	66,67
Kllokot	0	0	0	0,00	0,00
Graçanicë	47	12	1300	25,53	0,00
Ranillug	23	0	0	0	0
Partesh	0	0	0	0	0
Zveçan	13	13	245	100	0

2.1.11. Ndriçimi publik

Krijimi i kushteve për jetë dhe veprimtari të sigurt gjatë gjithë kohës (edhe gjatë natës) në vendbanimet publike, është njëra prej përgjegjësive më të rëndësishme të komunës. Për ta përmbushur këtë shërbim, komunat kanë bërë investime të konsiderueshme për të siguruar ndriçim publik në zonat urbane dhe në ato rurale. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet tre treguesëve: 1) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total a. Në zonën urbane; 2) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total b. Në zonën rurale / fshatra 3) % e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total, në qytet dhe në zonën rurale / fshatra.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshme e km rrugë me ndriçim publik në komuna është 48.79%. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të km rrugë me ndriçim publik janë: Kllokoti, Mitrovica e Veriut dhe Shtërpca (100 %), Prishtina dhe Zveçani (97%), Mamusha (88.46%) dhe Kamenica (86.96%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të km rrugë me ndriçim publik janë: Graçanica, Ranillugu dhe Parteshi (0%). Këto tri komuna ende nuk kanë nxjerrë vendim për zonën urbane të komunës, e gjithë territori ende llogaritet zonë rurale.

Përqindja mesatare e km rrugë me ndriçim publik në zonat rurale / fshatra është 20.50%. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të km rrugë me ndriçim publik janë: Kllokoti (100%), Shterpca (92%), Juniku (79.27%) dhe Gjakova (69.38%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të km rrugë me ndriçim publik janë: Gllogofci, Kaçaniku, Mitrovica e Veriut, Mamusha dhe Parteshi (0%).

Përqindja e përgjithshme mesatare e km rrugë me ndriçim publik është 32.57%, që njëherit është edhe përqindja mesatare e performancës së komunave për këtë fushë të shërbimeve. Numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e përgjithshme të vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.10.

Tab. 10. Performanca e komunave sipas treguesve për ndriçimin publik.

Komunat	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total a. Në zonën urbane	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total b. Në zonën rurale / fshatra	% e km rrugë me ndriçim publik – nga numri total, në qytet dhe në zonën rurale / fshatra
Mesatarja	**48.79**	**20.50**	**32.57**
Deçan	24.09	6.39	8.22
Gjakovë	48.00	69.38	55.88
Gllogoc	42.22	0.00	7.31
Gjilan	49.15	46.68	47.78
Dragash	50.00	0.89	3.47
Istog	52.27	3.29	9.48
Kaçanik	26.75	0.00	3.68
Klinë	9.00	2.69	6.22
Fushë-Kosovë	50.00	33.33	42.11
Kamenicë	86.96	16.50	23.55
Mitrovicë	80.00	59.00	62.59
Leposaviq	0.00	0.00	0.00
Lipjan	11.75	1.89	2.76
Novobërdë	3.23	1.31	1.90
Obiliq	24.00	8.00	10.67
Rahovec	78.43	4.81	14.25
Pejë	43.14	7.67	22.90
Podujevë	58.82	0.78	8.78
Prishtinë	97.70	23.77	60.46
Prizren	85.14	39.63	68.18
Skenderaj	15.82	3.70	1.96
Shtime	22.59	1.27	3.87
Shtërpcë	100.00	92.83	93.49
Suharekë	4.96	4.15	4.57
Ferizaj	84.44	17.54	37.54
Viti	17.19	17.84	17.63
Vushtrri	77.86	6.43	17.72
Zubin-Potok	77.50	10.94	13.19
Mitrovica e Veriut	100.00	0.00	12.41
Malishevë	54.84	0.39	55.23
Hani i Elezit	25.22	3.65	13.73
Mamushë	88.46	0.00	88.46
Junik	67.01	79.27	70.65
Kllokot	100.00	100.00	100.00
Graçanicë	0.00	65.58	65.58
Ranillug	0.00	35.71	35.71
Partesh	0.00	0.00	95.51
Zveçan	97.55	13.71	50.03

2.1.12. Furnizimi me ujë

Sigurimi i ujit të pijshëm dhe atij sanitar është shërbimi më themelor që komuna duhet ta përmbushë. Territori i Republikës së Kosovës, sipas të dhënave hidrografike, nuk është i pasur me sasi të mjaftueshme të ujit. Në këtë situatë ka ndikuar edhe prerja e pakontrolluar e pyjeve. Gjithashtu shumica e komunave ujin për qytetarët e vet e sigurojnë nëpërmjet kompanive rajonale publike apo kompanive publike të ujit. Në bazë të matjeve të tërthorta shumë km me ujësjellës janë me gypa të vjetruar dhe shumë km tjerë janë ujësjellës të rinj e të cilët asnjëherë nuk u kanë funksionalizuar (dërguar ujë qytetarëve). MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet katër treguesve: 1) % e ekonomive familjare të përfshira në

sistemin e ujësjellësit; 2) % e vendbanimeve të pajisura/përfshira - me sistem të ujësjellësit; 3) % e pagesave të ujit; 4) % e faturimit të ujit të pijshëm.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se përqindja e përgjithshme e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellsit në komuna është 67.84%%. Komunat të cilat kanë përqindjen më të lartë të përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e ujësjellsit janë: Gjakova, Peja, Mamusha, Juniku (100%), Fushë-Kosova (99.19%) dhe Shtimja (97.83%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të përqindjes së përfshirjes së ekonomive familjare në sistemin e ujësjellsit janë: Dragashi (10.2%) dhe Vitia (24.46%).

Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së përfshirjes së vendbanimeve në sistemin e ujisjellësit është 56.64%. Përqindja mesatare e përgjithshme e pagesave të ujit është 47.07 %. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të pagesave të ujit janë: Kamenica (91.59 %), Shterpca (87.77%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të pagesave të ujit janë: Novo-Bërda, Vitia, Zubin-Potoku, Mitrovica e Veriut, Mamusha, Kllokoti, Ranillugu dhe Zveçani (0%). Analiza e të dhënave tregon se numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.11.

Tab. 11. Performanca e komunave sipas treguesve për furnizim me ujë.

Komunat	% e ekonomive familjare të përfshira në sistemin e ujësjellësit	% e vendbanimeve të pajisura/përfshira - me sistem të ujësjellësit	% e pagesave të ujit	% e faturimit të ujit të pijshëm
Mesatarja	**67.84**	**56.64**	**47.07**	**47.71**
Deçan	66.1	64.86	52.47	43.87
Gjakovë	100	58.24	83.33	51
Gllogoc	42.63	26.32	69.87	29.13
Gjilan	76.03	33.33	66.67	34.61
Dragash	10.12	8.33	49.81	86.34
Istog	91.07	92.31	65.41	39.21
Kaçanik	47.25	22.58	74.19	53.55
Klinë	72.31	42.59	54.39	52.78
Fushë Kosovë	99.19	78.57	85	85.96
Kamenicë	34.29	3.45	91.59	40.31
Mitrovicë	91.96	86.96	43.31	41.11
Leposaviq	0	0	0	0
Lipjan	56.21	54.84	77.69	95.72
Novobërdë	32.14	42.42	0	0
Obiliq	68.6	83.33	59.22	44.92
Rahovec	93.33	85.29	75.06	47.72
Pejë	100	100	61.67	24.41
Podujevë	82.82	67.95	68.38	100

Prishtinë	85.49	65.91	44.22	75.97
Prizren	83.2	94.59	66.11	42.8
Skenderaj	39.66	27.78	55.64	35.77
Shtime	97.83	82.61	66.97	100
Shtërpcë	95.57	75	87.77	88.86
Suharekë	50	28.57	61.18	13.46
Ferizaj	92.52	88.89	62.07	84.52
Viti	24.46	10.26	0	81.95
Vushtrri	67.76	43.28	49.22	22.69
Zubin potok	43.21	23.44	0	100
Mitrovica e Veriut	0	100	0	0
Malishevë	62.87	40.91	66	45
Hani i Elezit	58.26	50	11.83	0.03
Mamushë	100	100	0	0
Junik	100	100	70.17	87.35
Kllokot	58.68	50	0	0
Graçanicë	89.71	75	61.23	63.84
Ranillug	85.48	76.92	0	0
Partesh	82.29	33.33	8.25	100
Zveçan	96.72	34.29	0	0

2.1.13. Kanalizimi dhe higjiena publike

Njëra ndër fushat e cila kërkon një angazhim të madh të komunave është largimi i ujërave të zeza nëpërmjet sistemit të kanalizimit me qëllim të ruajtjes së higjienës familjare dhe asaj publike. Komunat kanë ndërmarrë një numër të madh të masave për ndërtimin dhe sanimin e gjendjes së sistemit të kanalizimit, por të dhënat tregojnë se disa komuna kanë nevojë të punojnë më shumë në ofrimin e këtyre shërbimeve shumë të nevojshme për përmirësimin e higjienës në vendbanimet publike. Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet katër treguesëve: 1) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: a. Zona Urbane; 2) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: b. Zona Rurale; 3) % e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: c. Totali; 4) % e vendbanimeve në komunë të cilat posedojnë sistemin e ujërave të zeza – kanalizimeve.

Matja e këtyre treguesve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përqindjes së ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – në zonat urbane në komuna është 67.63 %. Përqindja e përgjithshme e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – në zonat rurale në komuna është 49.15 %.

Mesatarja e përqindjes së përgjithshme të vendbanimeve në komuna të cilat posedojnë sistem të kanalizimit është 54.82 %. Deçani dhe Mitrovica e Veriut nuk kanë raportuar se kanë sistem të kanalizimit – ujrave të zeza. Përqindja e përgjithshme mesatare e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit – fshatrat dhe qytetet në komuna është 63.56%. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të kyçjes së ekonomive familjare në sistemin e kanalizimit janë: Fushë-Kosova, Mamusha dhe Parteshi (100%), Graçanica (95.19%), Ferizaji (93.86%) dhe Podujeva (92.3%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të kyçjes së ekonomive familjare në sistemin e kanalizimit janë: Deçani, Dragashi, Obiliqi dhe Mitrovica e Veriut (0%).

Të dhënat tregojnë se numri më i madh i komunave ka treguar performancë mbi mesatarën e vendit në këtë fushë. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në tab.12.

Tab.12. Performanca e komunave sipas treguesve për kanalizim dhe higjienën publik.

Komunat	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: a. Zona Urbane	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: b. Zona Rurale	% e ekonomive familjare të kyçura në sistemin e kanalizimit: c. Totali	% e vendbanimeve në komunë të cilat posedojnë sistemin e ujërave të zeza - kanalizimeve
Mesatarja	**67.63**	**51.28**	**63.56**	**54.82**
Deçan	0	0	0	0
Gjakovë	90.24	53.35	59.36	32
Gllogoc	100	61.4	72.57	89.47
Gjilan	100	38.11	78.1	23.81
Dragash	90	17	21.55	30.56
Istog	30.2	31.7	30.92	36
Kaçanik	98.04	46.19	72.12	51.61
Klinë	80.96	52.27	85.27	61.11
Fushë-Kosovë	100	100	100	100
Kamenicë	100	41.1	53.94	17.24
Mitrovicë	100	72.6	86.76	84.78
Leposaviq	0	0	0	0
Lipjan	46.51	97.33	75.43	64.52
Novobërdë	0	75.89	75.89	27.27
Obiliq	88.23	80.85	84.11	88.23
Rahovec	77.58	93.54	85.83	97.06
Pejë	64.56	23.71	53.23	15.38
Podujevë	100	87.18	92.3	79.49
Prishtinë	92.97	41.36	85.48	65.91
Prizren	100	41.58	57.72	83.78
Skenderaj	48.56	32.71	60.31	27.78
Shtime	47.88	51.78	48.88	82.61
Shtërpcë	91.82	40.98	54.36	81.25
Suharekë	0	32.62	65.25	71.43
Ferizaj	96.61	90.16	93.86	95.56
Viti	98.81	7.5	22.12	69.23
Vushtrri	100	70.89	82.83	77.61
Zubin-Potok	83.04	6.68	39.68	4.69
Mitrovica e Veriut	0	0	0	0
Malishevë	73.32	57.34	58.76	68.18
Hani i Elezit	100	80.37	89.8	58.33
Mamushë	100	0	100	100
Junik	70.72	100	70.87	33.33
Kllokot	100	29.35	50.28	50
Graçanicë	0	95.19	95.19	100

Ranillug	0	25.93	25.93	30.77
Partesh	0	100	100	100
Zveçan	100	71.93	86.39	5.71

2.1.14. Grumbullimi i mbeturinave

Gjatë veprimtarisë së tyre, qytetarët hedhin mbeturina të llojeve të ndryshme, të cilat shpesh herë hudhen në vendet e palejuara duke dëmtuar rëndë mjedisin jetësor të qytetarëve. Hudhja e mbeturinave në vendet jo përkatëse, po e dëmton shëndetin e qytetarëve, po dëmton mjedisin dhe po e vështirëson procesin e mbledhjes dhe grumbullimit të tyre në vendet përkatëse. Të gjitha të dhënat flasin për mosfunksionimin e mirë të sistemit për grumbullimin e mbeturinave. Janë zhvilluar plane dhe Strategjia Kombëtare për Grumbullimin e Mbeturinave, por gjendja në terren nuk është përmirësuar shumë. Komunat dhe kompanitë publike të pastrimit kanë obligim që të rrisin performancën e tyre, në veçanti, për këtë fushë. MAPL raporton për performancën e komunave në këtë fushë nëpërmjet katër treguesve: 1) % e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit te mbeturinave; 2) % e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave; 3) % e pagesave të bëra.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përqindjes së përgjithshme të ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komuna është 54.06%. Përqindja e përgjithshme e e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave në komuna është 61.88%. Komunat të cilat kanë përqindje më të lartë të përqindjes së përfshirjes së vendbanimeve në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave janë: Mamusha, Juniku, Kllokoti, Graçanica, Ranillugu dhe Parteshi (100%), ndërsa komunat të cilat kanë përqindje më të ulët të përqindjes së përfshirjes së vendbanimeve në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave janë: Mitrovica e Veriut (0%) dhe Kamenica (20.69%). Ndërkaq mesatarja e përgjithshme e përqindjes së pagesave të bëra për ofrimin e këtij shërbimi është 53.78%.

Mesatarja e përgjithshme e performancës së komunave për këtë shërbim është 56.57%. Të dhënat tregojnë se numri më i madh i komunave ka treguar performancë në nivelin e mesatarës së vendit për këtë fushë. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Tab. 13. Performanca e komunave sipas treguesve për grumbullimin e mbeturinave.

Komunat	% e ekonomive familjare që kanë qasje në shërbimin e grumbullimit te mbeturinave	% e vendbanimeve të përfshira në shërbimin e grumbullimit të mbeturinave	% e pagesave të bëra
Mesatarja	**54.06**	**61.88**	**53.78**
Deçan	30.12	35.14	82.70
Gjakovë	71.77	34.07	78.07
Gllogoc	28.20	42.11	63.02

Gjilan	56.32	35.71	62.51
Dragash	23.32	55.56	69.33
Istog	19.25	53.85	81.33
Kaçanik	34.78	61.29	67.72
Klinë	56.21	29.63	59.93
Fushë-Kosovë	100.00	100.00	54.88
Kamenicë	38.96	20.69	59.19
Mitrovicë	99.19	89.13	60.4
Leposaviq	0.00	0.00	0.00
Lipjan	19.31	66.13	43.45
Novobërdë	0.00	95.83	37.04
Obiliq	37.64	66.67	71.81
Rahovec	46.40	100.00	26.81
Pejë	67.88	94.87	66.03
Podujevë	65.00	33.33	55.95
Prishtinë	67.18	43.18	69.06
Prizren	79.48	90.54	66.26
Skenderaj	41.83	31.48	61.46
Shtime	85.36	69.57	78.60
Shtërpcë	36.53	81.25	81.93
Suharekë	93.16	78.57	0.00
Ferizaj	75.45	75.56	70.99
Viti	27.39	46.15	0.00
Vushtrri	43.91	41.79	64.16
Zubin-Potok	43.21	23.44	0.00
Mitrovica e Veriut	0.00	0.00	0.00
Malishevë	66.33	54.55	60.62
Hani i Elezit	65.22	58.33	54.56
Mamushë	31.80	100.00	79.37
Junik	56.75	100.00	81.40
Kllokot	100.00	100.00	12.86
Graçanicë	100.00	100.00	65.54
Ranillug	100.00	100.00	61.40
Partesh	93.75	100.00	15.25
Zveçan	52.61	42.86	80.00

2.1.15. Deponimi i mbeturinave të ngurta

Krahas problemit të hedhjes dhe grumbulliit të mbeturinave, hudhja dhe deponimi i mbeturinave të ngurta është një problem në vete. Komunat në bashkëpunim me ministrinë përkatëse të linjës dhe Kompania për Menaxhimin e Deponive, kanë ndërtuar vende të caktuara për deponimin e mbeturinave. Në bazë të informatave, jo të gjitha deponitë i plotësojnë standardet përkatëse për deponimin e mbeturinave.

Raporti pasqyron performancën e komunave për këtë fushë nëpërmjet treguesi: 1) sasia e mbeturinave të deponuara për kokë të banorit.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e mbeturinave të deponuara për kokë të banorit në komuna është është 162 kg për kokë të banorit. Komunat të cilat kanë sasi më të madhe të deponimit të mbeturinave për kokë të banorit janë: Mitrovica e Veriut (526.36 kg / kokë banorit) dhe Zubin-Potoku (468.13 kg / kokë banorit), ndërsa komunat të cilat kanë sasi më të vogël të deponimit të mbeturinave për kokë të banorit janë: Rahoveci (26.87 kg), Hani i Elezit dhe Juniku (52.6 kg). Të dhënat tregojnë se numri më i madh i komunave ka deponuar sasi më të vogël të mbeturinave sesa mesatarja e vendit në këtë fushë. Kështu, prej 37 komunave sa kanë raportuar, 17 komuna apo 45.95% prej tyre kanë deponuar më shumë se mesatarja e vendit. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në graf. 17.

Graf. 17. Performanca e komunave sipas treguesve për deponimin e mbeturinave



3. Efikasiteti dhe efektiviteti i performancës së komunave

Analizat tregojnë se komunat kanë treguar një shkallë mesatare në ofrimin e shërbimeve komunale për qytetarët dhe palët e ndryshme të interesit. Komunat e Republikës së Kosovës kanë arritur një mesatare të performimit të tyre në shkallën prej 54.77%. Efikasiteti dhe efektiviteti i performancës së komunave është relativisht vështirë i konstatueshëm për faktin sepse treguesit e performancës masin vetëm sasinë e punëve të kryera, pa i krahasuar me ndonjë standard apo me atë çfarë ka qenë e planifikuar të realizohet. Gjithashtu, këtë e vështirëson edhe mungesa e treguesve financiarë, kur dihet se një institucion është efikas dhe efektiv kur arrinë rezultatet e planifikuara, të sasisë dhe cilësisë së njëjtë, në kohën e duhur dhe me koston më të ulët të mundshme.

Megjithatë, mesatarja e përgjithshme dhe ajo individuale e performancës së komunave tregon për një zhvillim pozitiv dhe një arritje mesatare në ofrimin e shërbimeve komunale për 15 fushat e matura deri tani. Nëse e krahasojmë mesatarën e përgjithshme të performancës për vitet: 2010, 2011 dhe 2012 me atë të këtij viti që po e lëmë (2014), vërejmë se mesatarja e përgjithshme e matur edhe me mendimin e qytetarëve ka qenë 44%, ndërsa tani është 54.77%, që i bie se kemi një rritje të performancës për 10%. Rritja e performancës për 10%, tregon trendin e rritjes së performimit të komunave prej 5% në vit.

Problemet. Gjatë analizave, në disa komuna janë vërejtur edhe të dhëna të cilat hyjnë në grupin e gabimeve logjike, si koha e reagimit në rastet emergjente për 0.1; 0.15; 0.13 minuta, pastaj numri i objekteve për aktivitete rinore, kulturore dhe sportive ka rezultuar të jetë më i vogël se në vitin 2013, sasia e deponimit të mbeturinave në komunën e Zubin-Potokut dhe Mitrovicës së Veriut për kokë të banorit është shumë më e lartë se mesatarja e vendit dhe nga informatat parësore që kemi tregon që nuk mund të jenë të sakta. Në disa raste janë hasur gabime aritmikore dhe në disa raste nuk ka të dhëna për njërin tregues që është i lidhur me treguesin tjetër të të njëtës fushë, e që rrjedhimisht është dashur të ketë. Në komunat: Dragash, Kamenicë, Novobërdë, Suharekë dhe Partesh është konstatuar një dallim i madh ndërmjet të dhënave të azhuritetit (% shumë e vogël e realizimit) me atë të performancës (shih shtojcën 1 dhe 2). Me verifikimin e të dhënave është konstatuar se zyrtarët e komunave nuk i kanë futur të gjitha lëndët e shqyrtuara në sistem për azhuritetin. Ne i jemi referuar të dhënave nga sistemi për azhuritet. Gjithashtu mungesën e të dhënave për azhuritetin për 2 komunat e veriut, për komunën e Zubin-Potokut dhe të Zveçanit i kemi shfrytëzuar të dhënat nga sistemi i performancës. Shih shtojcën nr. 2. Mungesën e të dhënave të performancës për shërbime administrative në komunën e Hanit të Elezit e kemi kompensuar me të dhënat e azhuritetit. Shih komunat përkatëse me të dhëna ngjyrë të kuqe në shtojcën nr. 2. E vetmja komunë që nuk ka raportuar as për performancë e as për zhuritet është Leposaviqi.

Me qëllim të eliminimit të këtyre problemeve, MAPL më 18 dhjetor 2014, ka organizuar trajnim me kordinatorët komunal për performancë. Në takim iu janë dhënë udhëzime të qarta për mënyrën e raportimit, me theks të veçantë në raportimin e të dhënave vetëm për vitin 2014. Po ashtu më 05 janar 2015, MAPL ua përkujton edhe njëherë se të dhënat duhet raportuar vetëm

për vitin 2014. Gjatë verifikimit të të dhënave, një numër i konsideruar i këtyre gabimeve janë eliminuar, por një numër i tyre është mbetur, pasi që komunat e kanë konfirmuar saktësinë e tyre të raportuar më parë. Nga konsultimet e drejtpërdrejta me konrdinatorët dhe zyrtarët e certifikuar, është konstatuar se shumica e komunave kanë raportuar në mënyrë komulative (për të gjitha vitet), në vend të raportimit vjetor ashtu si kanë qenë udhëzimet e MAPL. Kjo ka shkatuar probleme në matjen objektive të performancës për ato komuna të cilat kanë raportuar vetëm për një vit.

Mund të themi se këto gabime nuk ndikojnë në rezultatet përfundimtare në nivel të vendit dhe megjithatë mundësojnë të kuptuarit e trendit të performancëes së komunave për vitin 2014.

KAPITULLI IV

AZHURITETI

Mandati ligjor i MAPL në mbikëqyrjen dhe përkrahjen e komunave në ofrimin e shërbimeve në përputhje me ligjin dhe në përputhje me kërkesat e qytetarëve po zhvillohet drejt konsolidimit të sistemit për kontroll të vetëqeverisjes lokale dhe të efikasitetit dhe efektivitetit të pushtetit lokal në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve. Mbledhja e të dhënave për azhuritetin e komunave në përputhje me kërkesat e qytetarëve dhe pasqyrimi i tyre krahas raportimit të performancës, tregon për një qasje të standardizuar dhe të unifikuar të raportimit të të dhënave për punën e komunave në shërbim të qytetarëve. Kjo qasje mundëson që puna e komunave të bëhet sa më transparente dhe llogaridhënse përpara qytetarëve, përpara institucioneve qendrore dhe vetë institucioneve lokale.

4.1. Pasqyra e përgjithshme e azhuritetit të komunave

Në kuadër të Raportit Vjetor të Performancës për Komunat për vitin 2014, është përfshirë edhe pjesa e raportit që ka të bëjë me azhuritetin dhe efikasitetin e organeve komunale, i cili është i bazuar në regjistrat elektronikë të të dhënave të siguruara nga programi elektronik i instaluar në komuna CMS/CSC. Të dhënat pasqyrojnë punën e 35 komunave, ndërsa komunat e Leposaviqit, të Zveçanit dhe të Zubin-Potokut ende janë në proces të përfshirjes në sistemin elektronik CMS/CSC. Për arsye objektive të mungesës së këtij programi në komunat: Graçanicë, Ranillug, Partesh dhe Kllokot, të dhënat për azhuritetin dhe efikasitetin e organeve të këtyre komunave janë siguruar në mënyrë fizike, nga zyrtarët të cilët këto të dhëna i kanë siguruar në Qendrën për Shërbim të Qytetarëve. Në vazhdim të raportit janë të prezantuara të dhënat e përgjithshme për azhuritetin dhe efikasitetin e organeve për komunat e Republikës së Kosovës.

Matja e këtyre treguesëve është bërë nga përpunimi i të dhënave të raportuara nga komunat. Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se mesatarja e përgjithshme e lëndëve të pranuara është 49276 kërkesa. Komunat të cilat kanë pranuar numër më të madh të kërkesave janë: Prishtina (288485 kërkesa), Prizreni (185456 kërkesa) dhe Gjilani (143895 kërkesa), ndërsa komunat të cilat kanë pranuar numër më të vogël të kërkesave janë: Parteshi (1975 kërkesa), Kllokoti (3070 kërkesa) dhe mamusha (4479 kërkesa). Mesatarja e përgjithshme e kërkesave të shqyrtuara (miratuara) është 42428 kërkesa.Të dhënat tregojnë se numri më i madh i komunave ka treguar performancë nën mesatarën e vendit në këtë fushë. Të dhënat specifike për secilën komunë mund t'i gjeni në shtojcën e këtij raporti.

Komunat në përgjithësi kanë treguar një gadishmëri për t'iu ofruar qytetarëve shërbimet e kërkuara.

4.2. Efikasiteti dhe efektiviteti i azhuritetit të komunave

Në bazë të analizave të bëra është konstatuar se shumica e komunave kanë treguar shkallë të lartë të shqyrtimit të kërkesave të qytetarëve dhe të institucioneve qendrore për vitin 2014. Prej gjithsej 1,724,667 kërkesa të pranuara, 1,419,951 kërkesa janë miratuar, ndërsa 16045 kërkesa janë në proces të shqyrtimit. Prej gjithsej 35 komuna, 23 komuna kanë treguar azhuritet (performancë) më të lartë se mesatarja e përgjithshme e vendit prej 86.10%, 1 komunë – Gllogofci ka realizuar punën në shkallën 102% (ka bartë lëndë edhe nga viti i kaluar), ndërsa 11 komuna kanë treguar azhuritet më të ulët se mesatarja e përgjithshme e vendit dhe 2 komuna kanë qenë në nivelin e mesatares së vendit. Mesatarja e përgjithshme e përqindjes së performimit të komunave është 86.10%. Po ashtu, analizat kanë treguar se komunat kanë numër të ndryshëm të organizimit të brendshëm, edhe pse kryejnë punë të njëjtë. Komuna e cila ka më së shumti drejtori në raport me mesatarën e numrit të kërkesave në vend është: Vushtrria me 20 drejtori (64,309 kërkesa të shqyrtuara), Prizreni me 18 drejtori dhe 178,224 kërkesa të shqyrtuara apo 36% më shumë se Vushtrria, ndërsa komunat të cilat kanë më së paku drejtori në raport me mesatarën e numrit të kërkesave në vend janë: Kaçaniku, Mitrovica e Veriut, Mamusha dhe Juniku me nga 8 drejtori apo 4 drejtori më pak se mesatarja e vendit (12 drejtori) Në këtë raport nuk mund të matet realisht efikasiteti i komunave, pasi që nuk raportohet për dy tregues kryesorë që pasqyrojnë në shkallë më të plotë efikasitetin e komunave, siç janë: numri i të punësuarve në administratë për kokë të banorëve dhe shpenzimet financiare të komunave për sasinë dhe cilësinë e njëjtë të punës.

KAPITULLI V

NDIKIMET E PERFORMANCËS DHE AZHURITETIT

5.1. Ndikimet në funksionimin e sistemit të VQL

Qëllimi kryesor i sistemit të VQL është që t'u krijojë mundësi strukturave të pushtetit lokal për të performuar mirë dhe me përgjegjësi ndaj qytetarëve të komunave të Republikës së Kosovës. Ndërkaq performanca e komunave tregon për shkallën e funksionalitetit të sistemit të VQL. Me matjen e performancës së komunave, MAPL vlerëson dhe ndërmerr masat e nevojshme në hartimin e politikave që ta përmirësojnë funksionimin e sistemit të VQL në Kosovë. Shkalla e performimit të komunave tregon shkallën e funksionimit të sistemit. Nëse komunat performojnë dobët, atëherë duhet shikuar se çfarë nuk është duke funksionuar në sistemin e VQL. Gjithashtu duhet diagnostifikuar problemin saktë, sepse disa komuna, me të njëjtin sistem arrijnë rezultate shumë të mira. Edhe pse komunat tregojnë performancë të ndryshme me të njëjtin sistem, megjithatë, MAPL nëpërmjet të këtij procesi, ka mundësi që të kapë trendin e funksionimit të sistemit dhe të përmirësimit të performancës së komunave në vazhdimsi. Me raportimin e performancës së komunave bëhet e mundur edhe provimi i vetë Sistemit për Menaxhimin e Performancës së Komunave, me të cilën mundësohet rishikimi, korrigjimi, adresimi dhe zhvillimi dhe përparimi i sistemit.

5.2. Ndikimet në punën e komunave

Matja e performancës ka ndikim të drejtpërdrejt në punën e komunave. Përpos matjeve të brendshme që i bëjnë komunat punës së tyre, matja e jashtme është një mekanizëm profesional, që përdoret gjithandej në botë për t'i ndihmuar komunat në diagnostifikimin e asaj se çka është punuar mirë dhe çka mund të bëhet më mirë. Matje e performancës dhe e azhuritetit të tyre, është një instrument i fortë orientues dhe objektiv për t'u ndihmuar komunave në përmirësimin e vazhdueshëm të performancës së tyre në shërbim të qytetarëve dhe të palëve të interesit. Matja e jashtme e performancës është mjaftë profesionale, e analizuar nga këndvështrime të ndryshme dhe sjellë në pah praktikat më të mira të punës së komunave, nëpërmjet krahasimit, duke krijuar mundësinë e përfitimit nga këto praktika të gjitha komunat e Republikës së Kosovës. Raporti i performancës dhe i azhuritetit shërben si udhëzues për planifikim profesional të punëve në komuna për të ardhmen në funksion të përmirësimit të jetës së qytetarëve.

5.3. Ndikimet në ofrimin cilësor të shërbimeve

Gjetjet nga matjet, të pasqyruara në këtë raport, tregojnë se shumica e komunave ende janë nën mesatarën e vendit në ofrimin e shërbimeve. Publikimi i raportit krijon mundësinë e informimit dhe bërjen transparente të punës së komunave përpara qytetarëve dhe të gjitha palëve tjera të interesuara. Kështu, qytetarët kuptojnë më mirë të drejtat e tyre dhe përgjegjësitë e komunës për ofrimin e shërbimeve me cilësi. Qytetarët dhe palët e interesit bëhen pjesë aktive e performimit të komunave. Rezultatet e performancës i mbajnë komunat vazhdimisht përgjegjëse

ndaj obligimit për përmirësimin e ofrimit të shërbimeve. Me reflektimin e qytetarëve ndaj cilësisë së shërbimeve, komunat kalojnë shkallë-shkallë nga përgjegjësia në llogaridhënie për punën e tyre ndaj qytetarëve dhe palëve të interesit. Me raportimin e performancës së komunave krijohet një mekanizëm i natyrshëm i komunikimit të komunave me qytetarët e tyre, një kusht themelor për adresimin e nevojave dhe ngritjen e bashkëpunimit të ndërsjellë.

SHTOJCA 1: PASQYRA INDIVIDUALE E TË DHËNAVE PËR AZHURITETIN E KOMUNAVE

Komunat	Të pranuara	Të miratuara	Të refuzuara	Të pashqyrtuara	Në proces	Totali të kryera	Përqindja e realizmit
Deçan	28555	4602	330	23456	167	4932	17.27
Gjakovë	56116	47662	3098	4181	1175	50760	90.46
Gllogoc	53430	52757	2174	397	682	54931	102.81
Gjilan	143895	82563	8764	52822	46	91327	63.47
Dragash	23206	4144	57	18988	17	4201	18.103
Istog	5289	3080	534	235	1440	3614	68.33
Kaçanik	39329	37596	955	77	701	38551	98.02
Klinë	5726	4713	199	366	448	4912	85.78
Fushë-Kosovë	27386	26027	387	651	984	26414	96.45
Kamenicë	42439	4073	757	37306	303	4830	11.38
Mitrovicë	77032	67786	5881	1958	1407	73667	95.63
Leposaviq	0	0	0	0	0	0	0
Lipjan	53728	42678	1225	8964	861	43903	81.71
Novobërdë	7651	577	47	7027	0	624	8.16
Obiliq	26591	24861	485	806	439	25346	95.32
Rahovec	30169	15190	106	14873	0	15296	50.70
Pejë	91400	80228	3570	5303	2299	83798	91.68
Podujevë	102068	99156	2596	547	181	101752	99.69
Prishtinë	288485	242800	17058	28001	625	259858	90.08
Prizren	185456	171153	7071	6319	913	178224	96.10
Skenderaj	67473	66461	742	191	79	67203	99.60
Shtime	34380	32419	1818	138	13	34237	99.58
Shtërpcë	8916	8352	123	414	27	8475	95.05
Suharekë	7810	1269	4	6537	0	1273	16.30
Ferizaj	115389	107537	3046	2696	2286	110583	95.83
Viti	44695	43700	959	18	18	44659	99.92
Vushtrri	65722	62346	1963	1350	63	64309	97.85
Zubin-Potok	1552	0	0	52	0	1500	96.65
Mitrovica e Veriut	4578	3828	103	0	604	3931	85.87
Malishevë	31800	29903	95	1747	19	29998	94.33
Hani i Elezit	9386	9188	110	76	12	9298	99.06
Mamushë	4479	3970	18	491	0	3988	89.04
Junik	8660	8296	36	909	30	8332	96.21
Kllokot	3070	2948	83	11	28	3031	98.73
Graçanicë	21401	20614	614	0	173	21228	99.19
Ranillug	6982	6958	19	0	5	6977	99.93
Partesh	1975	516	0	1459	0	516	26.13
Zveçan	400	0	0	4	0	396	99.00
Totali	1726619	1419951	65027	228370	16045	1486874	86.11
Mesatarja	46665.38	40570.03	1857.91	6524.86	458.43	40185.78	86.11